



BASHKIMI EVROPIAN

Delegacioni i Bashkimit Evropian

Shkup, 10 korrik 2013

**Eveniment përfundimtar i projektit të financuar nga BE-ja  
Rishqyrtim i ligjeve, të kërkesave organizative dhe të  
resurseve për Bankën Kombëtare për procesin e integritimit  
në Bankën Qendrore Evropiane (ECB) dhe në Sistemin  
evropian të Bankës Qendrore (ESCB)**

Fjalim i

Ambasadorit Aivo Orav

Shef i Delegacionit të BE-së

**I nderuari Guvernator Bogov,  
I nderuari z. Asmussen,  
Ekselenca,  
Zonja dhe zotërinj**

Unë jam i nderuar që ndodhem në mesin tuaj sot në prezantimin e të arriturave të projektit Eurosystem të financuar nga BE-ja në bashkëpunim me Bankën Kombëtare.

Implementimi i suksesshëm i këtij projekti e tregon të arriturën e rëndësishme të përpjekjeve të përbashkëta të Bashkimit Evropian dhe të Bankës Qendrore Evropiane, së bashku me bankat qendrore të shteteve anëtare të Eurozonës, për mbështetjen e Bankës Kombëtare si një nga institucionet më të rëndësishme publike.

Me promovimin e stabilitetit dhe vetë-përmirësimit të vazhdueshëm, Banka Kombëtare ka merituar reputacion si një nga institucionet më të respektuara të vendit. Mbështetja e siguruar nga ky projekt ka ndihmuar në afrimin e rregullativave dhe kornizës operative në përputhje me kërkesat e BE-së.

Ekspert nga Banka Evropiane Qendrore dhe nga 11 banak qendrore të Eurosistemit e kanë ndihmuar Bankën Kombëtare në identifikimin e sferave për avancim të mëtejshëm. Rezultati përfundimtar i punës nëntë-mujore është një analizë të nevojave e cila ofron rekomandime se si të plotësohen standardet dhe

normat të domosdoshme për integrim të mëtejshëm në Sistemin evropian të bankave qendrore, ku bëjnë pjesë bankat qendrore të të gjitha shtetet anëtare të BE-së.

Përcjellja e rekomandimeve do të ndihmoj jo vetëm në përgatitjen e bankës për anëtarësim në BE por do ti forcoj kapacitetet për përballje me mjedisin gjithnjë e më të vështirë ekonomik. Ne besojmë se ekspertiza dhe udhëzimi do të kontribuojnë për stabilitetin ekonomik dhe financiar të vendit dhe rajonit. Këtë objektiv e ndajmë ne me ECB-në dhe do të vazhdojmë ta mbështesim Bankën Kombëtare. Raporti ofron bazë të rëndësishme për ndihmë të ardhshme të Bankës Kombëtare.

Në fund, dua t'ju falënderohem partnerëve të projektit për punën dhe dedikimin e tyre. Projekti për vlerësimin e nevojave tregoi se si ndihma e koordinuar me shumë partnerë nga institucione të shteteve anëtare të BE-së, jo vetëm që do të japin rezultate të duhura, por edhe do ta pasurojnë bashkëpunimin me institucionet e shteteve kandidate.

Ju falemnderit për vëmendjen tuaj.